



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME**  
**Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**  
**Nr.01-060/01-4803/24 datë:20.02.2024**



Npi – 01/93 datë: 23.02.2024

Duke u bazuar në nenin 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, për mbledhjen e mbajtur më: 23.02.2024, nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT**  
të mbajtur më datën: 23.02.2024 (e premte) në ora 08:30 h. në sallën e vogël

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja, znj.Albana Podvorica, Anëtarët e Komitetit: z.Asllan Beqaj, dhe z.Rexhep Gashi, dhe znj.Arbenita Brahim, z.Hamëz Tërshani.  
Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit, znj.Albana Podvorica, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 30.01.2024,
2. Informatë nga DKRS rreth zgjedhjes së sportistit të vitit 2023,
3. Informatë nga DKRS rreth shënimit të Epopesë së UÇK-së,
4. Informatë nga DKRS rreth realizimit të aktiviteteve të 15 Janarit dhe 17 Shkurtit,
5. Raporti vjetor i DKRS për punët dhe aktivitetet e OJQ-ve gjatë vitit 2023,
6. Informatë nga DKA rreth realizimit të 7 Marsit-Ditës së mësuesit.

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Asllan Beqaj;** Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës.

**\*Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

**Pika 1**

**Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 30.01.2024**

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Arbenita Brahim;** Përshëndetje, nuk kam vërejtje është gjithçka në rregull.

**\*Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 30.01.2024.**

**Pika 2**

**Informatë nga DKRS rreth zgjedhjes së sportistit të vitit 2023**

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Arbenita Brahim;** Informata na ka ardhur me kohë dhe e ka përshkruar fiks qysh ka ndodhë, zgjedhja e Sportistit.

**z.Asllan Beqaj;** Duhet ta bëjmë një rekomandim për Kryetarin për mungesë të drejtoreshës.

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Edhe unë jamë e pajtimit me bë një rekomandim për Kryetarin, faktikisht për arsye të mungesës së dy drejtoreshave, asaj të DKA-së dhe DKRS-së në mbledhjet e Komitetit për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport.

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Konstatoi Kuorumin, prezent në mbledhje ishin pesë (5) anëtarët e Komitetit.

\* **Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht vendosi që t'i Rekomandojë Kryetarin të Komunës së Shtimes z.Qemajl Aliu, që të merr parasysh rekomandimin e Komitetit për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport, me qëllim që drejtoresha e Arsimit si dhe Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport ose zyrtarët e autorizuar të drejtorive të cilët kanë pika për të prezantuar në mbledhje ose kanë Informata për të prezantuar në këtë Komitet, të marrin pjesë në mbledhje, sepse mbledhja e Komitetit po e humbë kuptimin dhe rëndësinë e sajë.**

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Rekomandimi vlenë për pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Rendit të ditës, meqenëse drejtoreshat nuk ishin prezent në mbledhje të Komitetit. Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi në ora 09:00h.

Procesmbajtës  
Idajet Rexhepi



---



Kryesuesja e Komitetit  
Albana Podvorica



---